



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT "ERMIR GODAJ"

Adresa : Rr.Abdi Toptani, Qendra Torre Drin, kati 2,nr.33 Tirane

Cel.0684054605,0682099471,email:ermirgodaj@mail.com

Nr. 128 /Prot.

Tirane, me 12/10 /2023

VENDIM

SHPLLJE ANKANDI TE DYTE PER SHITJEN E PASURISE SE PALUAJTSHME

Une Ermir GODAJ permbarues gjyqesor privat, i pajisur me Çertifikate Nr.82 Maj 2012 dhe me Nipt L217160221, pasi studiova materialet e dosjes permbarimore Nr.2236/Rregj., bazuar ne Urdherin e Ekzekutimit Nr.Regj.Them. 10966/1250 date 02.03.2022 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

KONSTATOVA:

Se me date 09.03.2022 eshte depozituar prane permbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj kerkesa e kreditorit Eljano Hoxha, se bashku me Urdherin e Ekzekutimit, leshuar per Titullin ekzekutiv (Deklarate Noteriale) Nr.2565/Rep., Nr.909/Kol. date 23.09.2020 te redaktuar nga notere Violeta Sulkaj, me pale dhe objekt:

Kreditori: Eljano Hoxha

Debitorë: Lindita Shehu

Objekti : Kthim Shume

Ne zbatim te Urdherit Ekzekutimit, me shkresen Nr.1338/Prot. date 09.03.2022 eshte njoftuar debitoria Lindita Shehu, te ekzekutoje vullnetarisht detyrimin qe ka sipas titullit ekzekutiv, detyrim i cili nuk eshte permbushur sipas afateve te parashikuara ne nenin 517 K.Pr.Civile dhe ne keto kushte eshte filluar ekzekutimi i detyrueshem duke urdheruar vendosjen e sekuestros mbi pasurite e luajtshme e te paluajtshme te debitorës Lindita Pandeli Shehu, per detyrimin ne shumate prej 21'500 (njezete e nje mije e peseqind) Euro dhe 257'134 (dyqind e pesedhjetete e shtate mije e njeqind e tridhjetete e kater) Leke.

Me shkresen Nr.1597/Prot. date 24.03.2022 eshte vendosur sekuestro konservative mbi pasurine e paluajtshme ne pronesi te debitorës Lindita Pandeli Shehu, e dtl.14.05.1972, te lene kolateral per detyrimin sipas Titullit Ekzekutiv te sipercituar sipas Kontrates se Hipotekes Nr.2567/Rep., Nr.911/Kol. date 23/09/2020 te redaktuar nga notere Violeta Sulkaj, si me poshte: "Toke Ullishte", me Nr.Pasurie 59/21, ndodhur ne Zonen Kadastrale 3292, Vol.12, Faqe 22, me siperfaqe 500 m², e ndodhur ne Selite, Tirane.

Konfirmuar regjistrimi i sekuestros mbi pasurine e paluajtshme te sipercituar nga ASHK-D.V.Rurale 1 me Nr.Regj.253355 date 06.04.2022(referuar karteles se pasurise se paluajtshme te sipercituar te dates 22.06.2022). Nga debitoria Lindita Shehu eshte shlyer ne menyre te detyrueshme pjeserisht detyrimi ne shumen prej 60'000 (gjashtedhjetete mije) Leke.

Ne vijim bazuar ne nenin 564 te K.Pr.Civile, me shkresen Nr.3264/Prot. date 18.07.2022 jane njoftuar palet per arritjen e marreveshjes per vleren e pasurise se paluajtshme te sekuestruar, marreveshje e cila nuk eshte arritur te behet nga palet, dhe ne keto kushte me vendimin Nr.3645/Prot. date 13.09.2022 eshte caktuar ekspert per vleresimin e pasurise se sipercituar.

Nga ekspertia e licencuar Znj.Xhekiola Beqiri, pajisur me Licence Profesionale Individuale Nr.regj. Vp.1564/1 dhe NIPT L31518004P eshte kryer vleresimi i pasurise se paluajtshme "Toke Ullishte", me Nr.Pasurie 59/21, ndodhur ne Zonen Kadastrale 3292, Vol.12, Faqe 22, me siperfaqe 500 m², e ndodhur ne Selite, Tirane, ne pronesi te debitorës Lindita Pandeli Shehu, e dtl.14.05.1972, dhe raport vleresimi eshte depozituar prane permbaruesit gjyqesor, ku rezulton se pasuria e paluajtshme e sipercituar sipas aktit te ekspertimit e ka vleren ne shumen prej 35'000 (tridhjetete e pese mije) Euro.

Me vendimin Nr.3915/Prot. date 22.09.2022 te permbaruesit gjyqesor i eshte komunikuar paleve vlera e pasurise se sekuestruar, sipas aktit te ekspertimit.

Duke pare aktet e dosjes permbarimore, rezulton se detyrimi ne total qe ka debitoria Lindita Shehu, eshte ne shumate prej 21'542 (njezete e nje mije peseqind e dyzete e dy) Euro dhe 229'134 (dyqind e njezete e nente mije e njeqind e tridhjetete e kater) Leke, nga te cilat detyrimi sipas titullit ekzekutiv ne shumate 21'500 Euro, aplikimi prane ASHK-se ne shumate prej 2'000 leke, shpenzimet e ekspertit vleresues ne shumate 30'000 Leke dhe tarifa fikse e sherbimit permbarimor e mbetur ne shumate 197'134 leke me tvsh, te ciles i shtohet 42 Euro qe eshte i barabarte me vleren 0,1% te vleres se sendit te sekuestruar + 20% tvsh.

Ne vijim me shkresen Nr.4263/Prot. date 05.10.2022 eshte njoftuar debitoria, te shlyeje brenda 10 (dhjete) diteve nga marrja dijene e ketij lajmerimi, detyrimin ndaj kreditorit ne shumate prej 21'542 (njezete e nje mije

peseqind e dyzete e dy) Euro dhe 229'134 (dyqind e njezete e nente mije e njeqind e tridhjetete e kater) Leke, pasi ne rast te mospagimit te detyrimit brenda afatit, pasuria e paluajtshme "Toke Ullishte", me Nr.Pasurie 59/21, ndodhur ne Zonen Kadastrale 3292, Vol.12, Faqe 22, me sipërfaqe 500 m², e ndodhur ne Selite, Tirane, ne pronesi te debitores Lindita Pandeli Shehu, do te shitet ne ankand me qellim shlyerjen e detyrimit dhe çmimi fillestar i kesaj pasurie ne ankandin e pare do te jete ne shumen 28'000 (njezete e tete mije) Euro, qe eshte vlera 80% e çmimit te percaktuar nga vleresuesi ne aktin e vleresimit.

Me tej, nga debitoria Lindita Shehu eshte shlyer pjeserisht detyrimi ne shumen prej 60'000 (gjashtedhjetete mije) Leke, konfirmuar me konfermen bankare te Raiffeisen Bank Sh.a. te dates 09.11.2022.

Duke qene se detyrimi i mbetur nuk është shlyer nga debitoria, ne keto kushte me vendimin Nr.5399/Prot. date 30.11.2022 eshte shpallur ankandi i pare per shitjen e pasurise se paluajtshme te sipercituar, ku çmimi i pasurise te paluajtshme, ne ankandin e pare ka qene ne shumen 28'000 (njezete e tete mije) Euro:

Me daten 15.12.2022 eshte zhvilluar ankandi i pare per shitjen e pasurise te sipercituar, dhe ne ankand nuk rezulton te jete paraqitur ndonje ofertues (bleres) per blerjen e kesaj pasurie (pasqyruar me proces-verbalin Nr.5677/Prot. date 15.12.2022).

Ne vijim bazuar ne nenin 577/1 te K.Pr.Civile, me vendimin Nr.5768/Prot. date 22.12.2022 eshte caktuar çmimi i ri i pasurise se paluajtshme te sekuestruar, ku çmimi ne ankandin e dyte do te jete ne vleren fillestare prej 19'600 (nentembedhjetete mije e gjashteqind) Euro.

Edhe pas kryerjes se ketyre veprimeve, rezulton se detyrimi ne shumen e mbetur prej 21,542 Euro dhe 182,384 leke nuk është shlyer nga debitoria, dhe ne keto kushte duhet te vijohet me shpalljen e ankandit te dyte per shitjen e pasurise se paluajtshme.

Sa me sipër, bazuar në nenin 577 të K.Pr.Civile,

V E N D O S A:

Shpalljen e ankandit te dyte për shitjen e pasurise së paluajtshme

- **"Toke Ullishte", me Nr.Pasurie 59/21, ndodhur ne Zonen Kadastrale 3292, Vol.12, Faqe 22, me sipërfaqe 500 m², e ndodhur ne Selite, Tirane, ne pronesi te debitores Lindita Pandeli Shehu, e dtl.14.05.1972, e lene kolateral per detyrimin sipas Titullit Ekzekutiv te sipercituar sipas Kontrates se Hipotekes Nr.2567/Rep., Nr.911/Kol. date 23/09/2020 te redaktuar nga notere Violeta Sulkaj.**
- **Çmimi me të cilin fillon shitja e sendit te paluajtshem te sekuestruar ne ankandin e dyte eshte ne vleren fillesatare prej 19'600 (nentembedhjetete mije e gjashteqind) Euro.**
- Secili ofertues duhet të depozitojë si garanci ne llogarinë e veçante te Permbaruesit Gjyqesor Privat Ermir Godaj **qe eshte pranë Bankës Raiffeisen, perkatesisht në numrin e llogarisë 0060371323 dhe me numër IBAN. AL5720211013000000060371323 (EURO), shumën prej 10% të çmimit fillestar.**
- Ankandi do të qendrojë i publikuar nga **data 12.01.2023 deri me datë 27.01.2023** dhe, zhvillohet në datë 27.01.2023 në përfundim të orarit zyrtar në Zyrën e Përmbarduesit Gjyqesor Privat Ermir Godaj, ndodhur ne Tirane Ruga "Abdi Toptani, qendra "Torre Drin", kt.2, nr.33.
- Ofertat duhet te hartohen ne gjuhen shqipe.
- Personat e interesuar ne lidhje me ankandin mund te terheqin dokumentacionin e nevojshem, si dhe mund te marrin informacion te hollesishem per pasurine e paluajtshme ne Zyrën e Permbaruesit Gjyqesor Ermir Godaj, ne adresen e sipercituar.
- Publikimi i këtij ankandi kryhet konform nenit 568 të K.Pr.civile, duke u afishuar ne zyren e permbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, ne vendin ku ndodhet sendi i sekuestruar, ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane, ne Bashkine Tirane, ne Njesise Administrative Nr.13, per 5 dite me radhe ne dy gazeta kombetare me tirazhin me te madh ne vend, si dhe ne vende te tjera publike qe jane te pershtatshme per shpallje ankandi.

U shpall sot me dt.12.01.2023.

PËRMBARUESI GJYQËSOR
Ermir GODAJ

